



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 146/4 Prot

Tiranë, më 11.03.2022

**V E N D I M**

Nr.39, datë 11.03.2022

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të pretendimeve të parashtruara nga nëpunësi \*\*\*\*\*, në lidhje me parregullsi në nisjen e procedurës disiplinore ndaj tij.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**Vërej se:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 146 prot., datë 8.2.2022, nga nëpunësi \*\*\*\*\*, i cili kryen detyrën “Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit”, pranë Autoritetit të Konkurrencës, është ngritur pretendimi se, procedura disiplinore ndaj tij, është nisur në mënyrë të padrejtë dhe mbi fakte të pavërteta, prandaj, kërkon ndërhyrjen e Komisionerit, për verifikimin dhe vlerësimin e shkeljes konkrete, si dhe për t’i garantuar të drejtat që ligji për shërbimin civil i garanton nëpunësit në një procedurë disiplinore.

Nga ana tjetër, vlerësimi i Komisionerit në lidhje me rrethanat e çështjes, është kërkuar edhe nga Komisioni i Disiplinës, pranë Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr.110/1, datë 21.2.2022, “Kthim përgjigje mbi procedurën disiplinore të nisur ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*, Drejtor i Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit”.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti, rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\*, është nëpunës civil në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit”, pranë Autoritetit të Konkurrencës. Me aktin nr. 84/1, datë 1.2.2022, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, e ka njoftuar se, në cilësinë e eprorit direkt, do të kërkojë ngritjen e Komisionit Disiplinor, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij, për masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. Motivacioni për nisjen e këtij procedimi disiplinor është plotësimi në mënyrë të pavërtetë i librezës së punës të nëpunësit \*\*\*\*\* me shënimin “Largim me kërkesë”, ndërkohë, që ky nëpunës, e ka mbyllur marrëdhënien e punës me masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, konstatuar kjo situatë, sipas procesverbalit nr. 84 prot., datë 1.2.2022.

Ky fakt, nga ana e eprorit, është konsideruar mospërmbushje e rëndë e detyrave, e cila, në bazë të pikës 2, shkronja “a”, të nenit 57, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, konsiderohet shkelje shumë e rëndë, për të cilën, sipas pikës 3, të nenit 60, të ligjit, jepet masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”. Në këtë rast, kompetencën për shqyrtimin e shkeljes, parashikuar në pikën 2, të nenit 59, të ligjit, e ka Komisioni i Disiplinës, i cili, në rastin konkret, është ngritur nëpërmjet Urdhrit nr.84/2, datë 2.2.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm dhe është thirrur me kërkesë të tij, në cilësinë e eprorit direkt, për të shqyrtuar çështjen në fjalë.

Komisioni i Disiplinës, ka njoftuar me shkrim nëpunësin nëpërmjet aktit nr. 84/4 prot., datë 4.2.2022, për fillimin e ecurisë disiplinore si dhe për shkakun e nisjes së kësaj ecurie disiplinore; për të drejtën e tij për të paraqitur me shkrim, sqarimet rreth shkeljes së pretenduar; për të drejtën për t’u dëgjuar vetë ose me përfaqësues ligjor; si dhe datën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar.

Më tej, në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 14.2.2022, sipas procesverbalit të mbajtur nga Sekretariati Teknik, ngritur për të asistuar Komisionin e Disiplinës, nëpunësi \*\*\*\*\*, ka paraqitur observacionet e tij (të cilat i ka depozituar edhe me shkrim), ku ai parashtron se, shkelja e pretenduar nuk qëndron, pasi, në të vërtetë, librezja e punës është e plotësuar prej tij me shënimin “Largim me kërkesë të Komisionit të Disiplinës”. Pas dëgjimit të pretendimeve të punonjësit të proceduar dhe vënies në dispozicion të Komisionit të Disiplinës të kopjes së librezës së punës, e cila ka të materializuar shënimin “Largim me kërkesë të Komisionit të Disiplinës”, anëtarja e Komisionit, \*\*\*\*\*, që kryen detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, nuk e ka vlerësuar si shkelje të rëndë këtë akt, duke arsyetuar se, nuk ka ardhur asnjë pasojë. Në përfundim të seancës, Komisioni i Disiplinës, ka konkluduar se do të shprehet pasi të shqyrtojë pretendimet dhe provat e paraqitura nga nëpunësi në fjalë.

Të gjitha aktet si më sipër, janë paraqitur nga Autoriteti i Konkurrencës, bashkëlidhur shkresës kthim përgjigje me nr.110/1, datë 21.2.2022, në të cilën kërkohet edhe vlerësimi i

Komisionerit për të sqaruar rrethanat që pretendohen nga institucioni si shkak për nisjen e ecurisë disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga palët, provohet fakti se, nëpunësi \*\*\*\*\* , në cilësinë e drejtuesit të njësisë së burimeve njerëzore, ka plotësuar librezën e punës të nëpunësit \*\*\*\*\* (në pozicionin Drejtor i Drejtorisë Juridike, Integritet dhe Çështjeve Gjyqësore, i cili është larguar nga Komisioni i Disiplinës nëpërmjet masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”), me shënimin “Largim me kërkesë të Komisionit të Disiplinës”. Ky shënim, përcakton edhe veprimin konkret që, në këtë rast, pretendohet si shkelje disiplinore nga eprori direkt dhe është shkak i fillimit të ecurisë disiplinore.

Për të arritur në konkluzione të sakta, Komisioneri e ka vijuar verifikimin edhe në përmbajtjen e dosjes së personelit dhe të rregjistrin të personelit, nga i cili rezulton se, masa disiplinore për nëpunësin \*\*\*\*\* , administrohet në dosjen e personelit që ruhet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit. Po kështu, masa disiplinore në fjalë, është e rregjistruar edhe në rregjistrin e personelit të institucionit, i cili është pjesë e Rregjistrin Qendror të Personelit që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Në këto rrethana, nuk evidentohet asnjë përpjekje e nëpunësit \*\*\*\*\* , për të fshehur faktin e pretenduar nga institucioni në dosjen e personelit apo në rregjistrin e personelit, që janë dy institute të ligjit, ku parashikohet dokumentimi i masës disiplinore, të përcaktuara në pikën 9, neni 59, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 20, të Kreut II, të Vendimit nr.115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, si dhe rregullave të Vendimit nr.833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të rregjistrin qendror të personelit”.

Për më tepër, në vijim të këtij argumenti, në këtë rast, as nuk ka ardhur dhe as nuk ka mundësi që të vijë ndonjë pasojë në dëm të administrimit të shërbimit civil, pasi RQP, është i aksesueshëm për masat disiplinore nga DAP dhe gjithë institucionet e tjera.

Shënimin në librezën e punës si, “Largim me kërkesë të Komisionit të Disiplinës”, Komisioneri e vlerëson si një perceptim dhe përdorim të gabuar të fjalës në shprehjen e shënuar në këtë dokument. Në një rast të tillë, Komisioneri vlerëson se, mund të ketë vend për tërheqje vëmendje për punonjësin në fjalë, që të tregojë kujdes në të ardhmen për fjalorin e përdorur në dokumentet e shkruara gjatë kryerjes së detyrës së tij, duke zgjedhur fjalët dhe shprehjet e duhura, rast pas rasti, por nuk ndodhemi në kushtet kur punonjësi është përgjegjës për një shkelje me faj të detyrimeve të nëpunësit civil sipas ligjit.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se, veprimi i kryer nga nëpunësi \*\*\*\*\*, nuk mund të klasifikohet si shkelje e disiplinës në shërbimin civil, pasi nuk përmban asnjë element që nenet 57 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikojnë në rastin e shkeljeve në shërbimin civil, e për pasojë edhe ecuria disiplinore e filluar në ngarkim të tij, duhet të ndërpritet.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Komisioni i Disiplinës pranë Autoritetit të Konkurrencës, që të rishqyrtojë çështjen, në lidhje me ecurinë disiplinore të nisur ndaj nëpunësit civil \*\*\*\*\*, i cili, aktualisht, kryen detyrën “Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Buxhetit dhe Komunikimit”, duke bërë një rivlerësim të rrethanave të ngjarjes dhe të veprimeve të kryera nga ky nëpunës, në kushtet kur nuk ka shkaqe të përligjura për vazhdimin e procedimit disiplinor në këtë rast.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, brenda 7 ditëve, nga marrja dijeni për këtë vendim, është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Autoriteti i Konkurrencës dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**